



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.238/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit DPT D... dhe NPSH K... me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.983/16 të datës 13.11.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit DPT D... dhe NPSH K... me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.983/16 të datës 13.11.2019, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.983/16, të datës 13.11.2019, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit DPT D... dhe NPSH K... me seli në Prishtinë, dhe ka mbet në fuqi Vendimi nr.122/2016, i datës 25.05.2016, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat Sylejman Klinaku nga Prishtina për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të prishet, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje ose ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë në konsideratë ekspertizën e pavarur financiare dt.15.09.2019 dhe provat në ekspertizë, dhe se aplikimi i metodës së shtimit të qarkullimit mbi bazën e deponimeve bankare është metodë jo ligjore. Fakti tjetër është se të

gjitha huazimet dhe deponimet në llogarinë bankare ishin bërë për të paguar kredinë në bankë, dhe të njëjtat nuk ishin pjesë e shitjeve apo qarkullimit siç pretendon ATK-ja. Gjithashtu mos njohja e shpenzimeve të transportit si shpenzim operativ është një prej kontestimeve tona me këtë kundërshtim, sepse e njëjta ka kundërshtuar edhe plotësimin e ekspertizës, e drejtë kjo e jona ta kërkojmë dhe gjykata është dashur ta aprovoj propozimin tonë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.122/2016 të datës 25.05.2016, nën pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.122/2016 të datës 15.04.2016 të subjektit NPSH “K...” dhe DPT “D...” me NRB, NF, me pronar z. N.B., me adresë në rrugën “...” nr... në Prishtinë, në lidhje me nenin 89, paragrafin 2, të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll, vërtetohen sit ë bazuara. Në pikën II të dispozitivit të vendimit, është vendosur që procedura e ankesës nuk ndërprejë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Paditësi ndaj këtij vendimi të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi në gjykatë, me të cilën ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurës respektivisht ka kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit nr.122/2016 të datës 25.05.2016 te paditurës ATK-së, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm, duke i propozuar gjykatës ta anuloi vendimin e kundërshtuar me padi dhe Raportin e Kontrollit dt.24.12.2015.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.122/2016, të datës 25.05.2016, të paditurës Administrata Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës te siguruara në procedurë të konfliktit administrativ, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Për gjykatën është i pabazuar pretendimi se mjetet financiare të deponuara janë huazime të cilat janë marrë për kthim të kredisë, e të cilat marrëveshje për kthim të huazimeve gjenden në shkresat e lëndës, sepse paditësi nuk ka mbajtur librin e arkës për tu evidentuar hyrjet. Këtë fakt e ka konfirmuar edhe eksperti financiar në seancën gjyqësore se paditësi nuk ka pasur qarkullim mb 50,000.00€ ku paditësi ka pasur obligim të mbaj librin e arkës që lidhet me librat e shitjeve-blerjeve. E paditura ka vepruar drejte kur paditësin e ka ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë për deponimet bankare në llogarinë e biznesit për arsye se paditësi në asnjë fazë të procedurës administrative nuk ka arritur që me prova dhe dëshmi konkrete të vërtetoj pretendimin se mjetet e deponuara e kanë burimin nga ndonjë burim i pa tatueshëm. Në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë faturë lidhur me njohjen e shpenzimeve për shërbimet e transportit të kryera për subjektin F..., nuk gjendet as libri i blerjes apo shpenzimeve të cilin fakt e ka konstatuar edhe ekspertiza financiare Andaj, pretendimet e

paditësit, gjykata nuk i aprovoi, sepse të njëjtat i ka vlerësuar si të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kolegji konstaton, se gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë në konsideratë ekspertizën e pavarur financiare dt.15.09.2019 dhe provat në ekspertizë, dhe se aplikimi i metodës së shtimit të qarkullimit mbi bazën e deponimeve bankare është metodë jo ligjore, Këto pretendime ankimore Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, si dhe janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Ngase gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konsideruar se marrëveshjet për kthim të huazimeve që gjenden në lëndë, nuk janë të evidentuara në hyrjet dhe daljet e regjistrimeve të huazimeve të pretenduara, dhe si të tilla këto marrëveshje në formë të shkruar nuk paraqesin dëshmi bindëse se mjetet e deponuara kanë burimin nga ndonjë burim i pa tatueshëm. Gjykata e shkallës së parë i ka dhënë mundësi paditësit nxjerrjen e provës përmes ekspertit financiar, i cili ka pranuar para gjykatës se paditësi nuk ka mbajtur librin e arkës dhe dokumentacionet tjera për tu dëshmuar hyrjet dhe daljet e regjistruara. Po ashtu sa i përket qarkullimit shtesë për faturat e shërbimeve të transportit nga eksperti është konstatuar se në shkresat e lëndës nuk ka pasur fatura të shpenzimeve të transportit në raport me subjektin F..., për t,iu njohur këto fatura si shpenzim.

Andaj, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është refuzuar kërkesëpadia e paditësit, për arsye se e paditura ka aplikuar drejt legjislacionin tatimor në këtë rast nenin 30 pika 3 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 dhe nenit 19.3 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kur e ka ngarkuar paditësin me qarkullim dhe tatim shtesë, në bazë të mjeteve të deponuara në llogarinë bankare pa dëshmuar burim të tatueshëm të këtyre mjeteve financiare dhe vlerësimit tjetër i mos pranimit të shpenzimeve për shërbimet e transportit për subjektin F..., për shkak të mos posedimit të faturave të këtyre shpenzimeve nga ana e paditësit. Kolegji i vlerësoi deklaratat me shkrim të huadhënësve të cilat i ka prezantuar paditësi para gjykatës së shkallës së parë, mirëpo këto

deklarata me shkrim janë krejtësisht jo valide dhe të pa vërtetuara saktësia e tyre, kështu që këto deklarata me shkrim nuk mund të merren si prova të bazuara për tu argumentuar ndodhja e huamarrjeve mes paditësit me personave tjerë fizik. Prandaj pavarësisht pretendimeve ankimore se nga mjetet e deponuara në llogarin bankare paditësi ka pasur për qëllim pagimin e kredisë në Bank, Kolegji vlerësoi se paditësi ka pasur obligim ligjor të paraqes para paditurës dhe gjykatës së shkallës së parë, burimin e deponimeve bankare në bazë të cilave është ngarkuar me qarkullim dhe tatim shtesë, e në anën tjetër gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar me të drejt gjendjen faktike, se paditësi nuk ka paraqit dokumentacion apo çfarëdo burimi për të dëshmuar prejardhjen e mjeteve financiare, ndërsa në rastin konkret deklaratat me shkrim të personave fizik që gjenden në lëndë, janë të papranueshme për tu trajtuar si prova mbi prejardhjen e mjeteve financiare. Kolegji i vlerësoi si të pamjaftueshme pretendimet ankimore lidhur me njohjen e shpenzimeve operative të faturave me subjektin F..., sepse paditësi nuk ka prezantuar fatura, libër të shpenzimeve për tu evidentuar këto shpenzime, e të cilat dokumentacione për tu pranuar si shpenzime duhet përmbajtur dispozitës së nenit 23 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, nenit 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.238/22 datë 13.10.2022

Kryetar i kolegjit
Krenar Berisha